



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi **1** i Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 7, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.10/03 prill 2019), nenit 24, dhe nenit 25 të Rregullores QRK nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 52, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.4.2024, mori këtë:

V E N D I M

PËR VAZHDIMIN E KONTRATËS PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, QENDRËS SOCIALE EDUKATIVE “DON BOSKO”

- I. MIRATOHET** Propozimi i Kryetarit të komunës për vazhdimin e kontratës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, Qendrës Sociale Edukative “Don Bosko”, Prishtinë.
- II.** Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është:
 1. Parcela kadastrale, nr. 2902-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 30000 m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, certifikata e pronës nr. P-71914059-02902-2, bazuar në raportin nr. 03-923-2023, dt. 24.11.2023, për përmbushjen e qëllimit të kontratës nga shfrytëzuesi.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është interesi i përgjithshëm, ruajtja, si dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, pasi që në këtë pronë është ndërtuar objekti i Qendrës Sociale Edukative “Don Bosko”, që ka për qëllim zhvillimin e procesit edukativo-arsimor në harmoni me kornizën ligjore strategjike të arsimit parauniversitar, zhvillimin e trajnimeve profesionale dhe aktiviteteve të ndryshme jashtëkurrikulare.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është për 50 vjet.
- V.** Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij vendimi jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të komunës dhe shfrytëzuesit.

- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i komunës, Drejtorja e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozim-vendimi janë:
- kërkesa,
 - certifikata e pronës dhe
 - kopja e planit.
- X.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb-faqen e komunës në gjuhët zyrtare.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/06-54405/24, më 26.4.2024

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



A r s y e t i m

Drejtoria e Pronës ka pranuar kërkesën zyrtare, nr.13-016/01-0231300/23, dt. 12.12.2023, nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, dhe raportin nga Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, nr. 03-923-2023, dt. 24.11.2023, për vazhdimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, 01. nr. 46-3714, dt. 31.1.2012, Qendrës Social Edukative “Don Bosko”, në parcelën kadastrale nr. 2902-2, Zona kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 30000 m².

Në bazë të këtij vendimi i mundësohet Qendrës Social Edukative “Don Bosko”, zhvillimi i procesit edukativo-arsimor në harmoni me kornizën ligjore strategjike të Arsimit parauniversitar, si dhe zhvillimi i trajnimeve profesionale dhe aktiviteteve të ndryshme jashtëkurrikulare, në parcelën kadastrale nr. 2902-2, ZK – Prishtinë, të kenë të drejtën e shfrytëzimit të parcelës për nevojat e tyre, me sipërfaqe të përgjithshme prej 30000 m².

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është 50 vjet. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës komunale do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe shfrytëzuesit.

Drejtoria e Pronës e ka shqyrtuar kërkesën e lartcekur, për vazhdimin e Vendimit, 01 nr. 46-3714, dt. 31.01.2012, për dhënien në shfrytëzim të parcelës kadastrale, e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, P- 71914059-02902-2, Zona kadastrale Prishtinë.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, sipas këtij propozimi, është parcela nr. 2902-2, që shfrytëzohet për Qendrën Sociale Edukative “Don Bosko”, në Prishtinë.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore si në pjesën hyrëse të këtij Propozimi, kërkesës nr. 13-016/01-0231300/23, dt.12.12.2023, nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, raportit të përcjellë nga Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, si dhe në shkresat e lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.